



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljenol/Prodato Received/Delivery	05.05.2021	702	1	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRIMSHK	2206/2021		116	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 208/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1197/2019 të datës 29.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.180/2019 të datës 08.03.2019, të parashtruar nga kundër Inspektoratit të Arsimit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil si dhe nenin 47 dhe 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.180/2019 e datës 08.03.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2018 i datës 26.12.2018 për ankuesen.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën "Inspektore e Arsimit", në Inspektoratin e Arsimit, me datën 08.03.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1227/2019, e regjistruar me numër A.nr.180/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vlerësimit të Rezultateve në Punë për Vitet 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018, vërejtjeve me shkrim nga Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë me ref.10 nr.721 të datës 08.11.2017, ref. 10. Nr.722 të datës 08.11.2017, ref. 10 nr.723 të datës 08.11.2017, ref.10 nr.724 të datës 08.11.2017 dhe ref.10 nr. 725 të datës 08.11.2017, si dhe mos veprimin të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.03.2019 ka proceduar të Ministria e

Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses. Ndërsa me datë 08.08.2017 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitur vetëm nga ankuesja e jo nga organi i punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Kosovës, me ç'arsye Këshilli me shkresën numër protokoll 1965/2019 të datës 18.04.2019, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së saj me numër A.nr. 180/2019 e datës 08.03.2019, duke udhëzuar për të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Pas këtij njoftimi, ankuesja ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative e cila me Aktgjykimin A.nr.1197/2019 të datës 29.03.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.04.2019 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të vendos për ankesën e ankuesit të datës 08.03.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen meritore të çështjes ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.03.2019 e parashtruar nga ankuesja me numër protokoll 1227/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për informim Nr. 1958/2019 e datës 18.04.2019, prova shtesë Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë e datës 26.12.2018, Formularin e regjistrimit të ankesës nr. 000123 e datës 08.03.2019, Kërkesën për dokumente të bashkangjitura nr.1532/2019, e datës 22.03.2019, Ankesën nr.prot.220 të datës 08.03.2019, Raportin vjetor i vitit 2018, Raport për vizitën studimore, e-mali i datës 31.12.2018; e-mail i datës 28.12.2018; e-mail e datës 26.12.2018, e-mail i datës 21.12.2018, e-mail i datës 26.12.2018; e-mail i datës 10.01.2019; e-mail i datës 09.01.2019, Thirrjen për urgjence mjekësore; Formular për caktimin e objektivave; e-mail i datës 14.12.2018; e-mail i datës 04.02.2019; Kërkesën për realizimin e punëtorisë me Inspektor të Arsimit, e-mail i datës 04.05.2017; Procesverbalin Ref.10 Nr.Prot.115 të datës 20.03.2018; Vendimin nr.2-/203 të datës 05.06.2018; e-mail i datës 10.01.2019, Vendimin me numër protokoll 2-940-2 i datës 14.05.2018, e-mail i datës 06.05.2018; Vendimin nr.2-2522/2 të datës 20.11.2018; Vendimin nr.2-2522/1 të datës 20.11.2018; Vendimin nr.01 të datës 21.02.2018; Vendimin me numër.10 të datës 21.02.2018; e-mail i datës 31.12.2018; Ftesën e datës 22.01.2018; e-mail i datës 10.03.2019; Vendimin e datës 21.03.2018, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Listën e Distribuomit, Vendimin nr.1630/2018 i datës 21.03.2018; Vendimin nr. 1351 i datës 29.05.2018; Vendimin numër. 2-3968 i datës 08.12.2017; Formularin për caktimin e objektivave nr.10 i datës 04.01.2018; e-mail i datës 10.01.2019; Vendim Ref.10 numer.046, i datës 16.01.2019; e-mail i datës 21.01.2019; e-mail i datës 06.02.2019; e-mail i datës 05.02.2019, e-mail i datës 16.02.2018; e-mail i datës 20.02.2018; e-mail i datës 30.03.2018, e-mail i datës 30.03.2018; e-mail i datës 12.12.2018; e-mail i datës 11.12.2018, e-mail i datës 10.12.2018; Raporti vjetor i viti 2017 i datës 09.01.2018; Formulari për caktimin e objektivave; e-mail i datës 12.06.2017; E-mail i datës 04.01.2017; e-mail i datës 29.12.2016, e-mail i datës 26.09.2017; e-mail i datës 02.11.2017; e-mail i datës 16.03.2017, e-mail i datës 07.03.2017, e-mail i datës 27.01.2017; Ankesë për vlerësimin e rezultateve në punë e datës 16.01.2017; Dosja nr. 10 e datës 2017, e-mail i datës 26.09.2017; e-mail i datës 06.01.2017; e-mail i datës 05.01.2017, e-mail i datës 11.02.2016; e-mail i datës 08.02.2016; e-mail i datës 01.02.2016; e-mail i datës 01.02.2016; e-mail i datës 07.11.2016, Raportin vjetor i vitit 2016 me numër protokoll 698, i datës 14.12.2016; Formularin për caktimin e objektivave i datës 01.01.2016-31.12.2016; e-mail i datës 12.02.2016; e-mail i datës 11.02.2016; Raportin vjetor i vitit 2015, me numër.prot.384 i datës

18.12.2016; Ftesë, Listë distribuimi; e-mail i datës 17.09.2015; e-mail i datës 11.09.2015; e-mail i datës 20.01.2015; Raporti vjetor i vitit 2014; Kërkese për interpretim ligjor nr.10/protokolli 465 i datës 21.01.2014; e-mail i datës 08.01.2016 ;Raporti vjetor i vitit 2013; Listë Distribuimi; Formular për vlerësimin vjetor të punës; Listë distribuimi; Komisioni disiplinor nr.10 i datës 15.03.2017; Vendimi me nr.10/71 i datës 08.02.2017; Formular për caktimin e objektivave; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 13.12.2014; Listë distribuimi e datës 31.12.2015 dhe Formular për vlerësimin e rezultateve në punë, vendimi nr.22-1351 i datës 29.03.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MASHT..

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se ankuesja është e sistemuar në pozitën e Inspektorese së Arsimit në Inspektoratin e Arsimit, në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (me tej MASHT).

Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit, në cilësi të Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses, më datë 26.12.2018 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 për ankuesen në pozitën Inspektore e Arsimit, duke dhënë notë të përgjithshme vlerësimi tre (3).

Ankuesja e pakënaqur ma Vlerësimin e Rezultateve të Punës për vitin 2018, me datë 09.01.2019, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 91, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (me tej KZKA), duke atakuar edhe vlerësimet e punës nga viti 2014 deri 2017.

KZKA-ja nuk ka shqyrtuar ankesën e datës 09.01.2019 të parashtruar nga ankuesja, dhe pas kësaj heshtje administrative të KZAK-së, ankuesja ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil kundër vlerësimeve të Rezultateve në Punë për vitin 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018, Vërejtjeve me shkrim të datës 08.11.2017 me ref.10 nr.721 të datës 08.11.2017, ref. 10. Nr.722 të datës 08.11.2017, ref.10 nr.723 të datës 08.11.2017, ref.10 nr.724 të datës 08.11.2017 dhe ref.10 nr. 725 të datës 08.11.2017, si dhe për shkak të mos veprimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me pretendimin se veprimet e Drejtorit të Përgjithshme të Inspektoratit të Arsimit janë në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore dhe së mos veprimi i KZKA-së është në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me vlerësimet e rezultateve të punës për periudhat e kundërshtuara me ankesë, Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2014 për ankuesen është bërë nga Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt me datë 31.12.2014 me notë të përgjithshme vlerësimi 2.24, e të cilin vlerësim ankuesja nuk e ka nënshkruar. Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2015, është bërë me datë 31.12.2015 me notë të përgjithshme 1.88, ku po të njëjtin vlerësim ankuesja nuk e ka nënshkruar. Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2016, është bërë me datë 29.12.2016, me notë të përgjithshme 1.88, e që ankuesja serish nuk e ka nënshkruar. Ndërsa për vitin 2017, nuk ka dëshmi se i është bërë vlerësimi i rezultateve të punës së ankueses nga ana Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë.

Ankuesja vlerësimet e rezultateve në puna për vitet nga 2013 deri 2016, i ka kundërshtuar përmes ankesës se parashtruar me datë 16.01.2017 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe

Ankesave të MASHT, ku nuk ka dëshmi se KZKA-ja ka vendosur lidhur me këtë ankesë dhe se ankuesja pas heshtjes administrative të KZKA-së, ka iniciuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Përkitazi me pretendimet ankimore kundër vërejtjeve të specifikuara në ankesë, Kolegji nga vlerësimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se vetëm Vërejtja me Shkrim ref.10.nr.724 e datës 08.11.2017 është shqiptuar ndaj ankueses nga Drejtori i Përgjithshëm në cilësi të Eprorit të saj të drejtpërdrejtë, ndërsa vërejtjet tjera i referohen inspektoreve tjerë të arsimit respektivisht Vërejtja me Shkrim ref.10.nr.722 e datës 08.11.2017 i është shqiptuar Vërejtja me Shkrim ref.10.nr.721 e datës 08.11.2017 i është shqiptuar Vërejtja me Shkrim ref.10.nr.723 e datës 08.11.2017 i është shqiptuar Muhamet Maliqit, dhe Vërejtja me Shkrim ref.10.nr.725 e datës 08.11.2017 i është shqiptuar

Kundër vërejtjeve me shkrim me shënime si me lart, zyrtaret e lartë pamenduar me datë 09.11.2017, kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i cili nuk ka shqyrtuar ankesën e datës 09.11.2017. Kundër heshtjes së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesja me datë 29.12.2017 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, i cili me Vendimin A/02/810/2017 të datës 21.03.2018, ka detyruara Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MASHT, që të shqyrtoj ankesën me nr.730-3651 të datës 09.11.2017. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, KZAK-ja ka shqyrtuar ankesën me numër 730-3651 të datës 09.11.2017, dhe me Vendimin nr.2-1351 të datës 29.03.2018, ka miratuar ankesën si të bazuar dhe ka shfuqizuar vërejtjet me shkrim me ref.10.nr 721 të datës 08.11.2017, ref.10.nr. 722 të datës 08.11.2017, ref.10.nr. 723 të datës 08.11.2017, ref.10.nr. 724 të datës 08.11.2017, dhe ref.10.nr. 725 të datës 08.11.2017.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 127 është përcaktuar se: *Ankesa duhet të parashitrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashitrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.* Ndërsa Rregullorja Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, përkatësisht neni 15 ka përcaktuar se: *Nëpunësi civil, në rast të pakënaqësisë me vlerësimin e bërë, ka të drejtë ankesë në pajtim me Rregulloren nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave,* e ndërlidhur me këtë neni 8 paragrafi 2 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave ka paraparë se: *2. Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur ankuesi konsideroj se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës.* Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjor, Kolegji konstaton se ankesa e datës 16.01.2017, e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MASHT, kundër Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2013, 2014, 2015 dhe 2016 është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuara me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave. Po ashtu ankesa e parashtruar në Këshill me datë 08.03.2019 lidhur me pretendimin ankimor për vlerësimin e rezultateve të punës për vitet 2013 deri 2016, pas heshtjes së KZAK-së lidhur me ankesën e datës 16.01.2017, është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ndërsa kundër mos Vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2017, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshill, pa shtjerë të drejtën e ankesës se brendshme

respektivisht brenda institucionit ashtu siç përcaktohet me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Përkitazi me pretendimin ankimor kundër vërejtjes me shkrim ref.10.nr. 724 të datës 08.11.2017 të shqiptuar ndaj ankueses nga Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë, e duke nisur nga fakti se KZAK-ja në zbatim të Vendimit të Këshillit me numër A/02/810/2017 të datës 22.03.2018 ka shfuqizuar Vërejtjen në fjalë, Kolegji konstaton se qëllimi i ankesës lidhur me këtë pretendim ankimor është bërë i kot, ashtu siç parashihet me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.*

Lidhur me pretendimin ankimor për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018, dhe pas konstatimit se ankesa është e pranueshme ndërlidhur me këtë pretendim ankimor, Kolegji për Shqyrtimin Ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civilë përkatësisht nenin 33 ku është përcaktuar se: *1.Në çdo institucion të administratës qendrore dhe komunale kryhet periodikisht, në fund të çdo viti, vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë. Vlerësimi i rezultateve në punë kryhet me qëllim të rritjes së suksesit të punës dhe për të siguruar përmirësimin gradual të aftësisë profesionale dhe të cilësisë së shërbimeve administrative.2.Vlerësimi i rezultateve në punë mbështetet në verifikimin e realizimit të objektivave të caktuara në fillim të periudhës së vlerësimit nga nëpunësi. Vlerësimi i rezultateve në punë është i detyrueshëm për mbikëqyrësit. Moskryerja mund të përbëjë shkak për fillimin e procedurës për masë disiplinore.3.Mbikëqyrësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë. Mosrealizimi i vlerësimit nga ana e mbikëqyrësit përbënë shkak për fillimin e procedurës për masë disiplinore ndaj tij/saj, si dhe Rregulloren Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *1.Vlerësimi i rezultateve të punës, nënkupton procesin e vlerësimit të realizimit të objektivave të punës për çdo nëpunës civil dhe vlerësimin e aftësive të nëpunësit civil, që kanë shërbyer në arritjen e objektivave.**

Në kuptim të dispozitave si me lartë si dhe duke u bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka konstatuar së Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit në cilësi të Udhëheqësit drejtpërdrejtë të ankueses, lidhur me pjesën e realizimit të objektivave të punës për vitin 2018 ka vlerësuar ankuesen me notë 1.8, ndërsa lidhur me Pjesën e aftësive për realizimin e objektivave ka dhënë vlerësim me notë 1.2, gjithsej nota e përgjithshme tre (3), e qe në vështrim të nenin 7 paragrafi 2 nen paragrafi 2.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil ku përshihet se: *Nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë";* dhe paragrafin 3 nën paragrafi 3.3 të po të njëjtit nen është përcaktuar se : *3. "mirë", vlerësohen nëpunësit civil, të cilët i kanë arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të të gjitha aktiviteteve) dhe kanë treguar aftësi dhe cilësi të pritshme,* rezulton së ankuesja është vlerësuar se ka përmbushur objektivat e punës të përcaktuara nga udhëheqësi i saj për vitin 2018, e mbi këtë baza rrjedhë së pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Ndërsa përkitazi me vërejtjet e ankueses të dhëna me shkrim në formularin e vlerësimit, në pjesën e aftësive që kanë të bëjnë me planifikim, organizim dhe vendimmarrje, Kolegji konstaton se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë të ankueses ka vepruar drejtë lidhur me mos vlerësimin e ankueses përkitazi me këto aftësi, për faktin së aftësitë e planifikimit, organizimit dhe vendimmarrjes i referohet aftësive menaxherial.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave po ashtu nga shqyrtimi provave të lëndës ka konstatuar se Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses, Vlerësimin e Rezultate të Punës për ankuesen për periudhën 01.01.2018 deri 31.13.2018 e ka bërë brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullores Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil ku shprehimisht thuhet se: *1.5 Periudha e vlerësimit, nënkupton periudhën gjatë së cilës kryhet procedura e vlerësimit të rezultateve në punë dhe zgjat nga 1-31 dhjetor të vitit të vlerësuar.*

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A. nr. 208/2021

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi




Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoratin e Arsimit
- Arkivit të KPMSHCK-së

